



_____ | Translation in Motion

THIRRJE PËR APLIKIM - REZIDENCA PËRKTHIMI NË TIRANË

Residencies for translators from the Western Balkans _____

| 17 SHKURT

POETIKA, pjesë e RECIT network dhe e partneritetit të Programit *Translation in Motion* fton përzemërsisht përkthyesit letrarë të gjuhëve të Bashkimit Europian, që përkthejnë në shqip dhe nga shqipja në këto gjuhë, për të aplikuar për një muaj qëndrimi në Rezidencën e Përkthimit në Tiranë (Shqipëri).

Afati i aplikimit: Afati i fundit për aplikime është dita e premte, **30 prill 2021**.

Rezidencat janë parashikuar të zhvillohen mes muajve **shtator/tetor/nëntor 2021**.

Aplikimi dhe përzgjedhja: Për të aplikuar, kandidatët dërgojnë si pjesë e dokumentacionit një letër motivimi, ku përshkruhet interesimi i tyre për Rezidencën e Tiranës; arsyeja dhe synimi i asaj që synojnë të arrijnë përmes këtij qëndrimi; një përshkrim i projektit përkthimor letrar, për të cilin do të punojnë gjatë qëndrimit në Rezidencë; një CV si dhe një listë e botimeve të përkthyera. Të interesuarit luten të dërgojnë kërkesën e tyre në **info poeteka@gmail.com** me *Translation in Motion* si subjekt të emailit. POETIKA dhe Komiteti Drejtues i partneritetit të programit *Translation in Motion* do të bëjnë përzgjedhjen dhe **deri më 15 maj 2021**, do të shpallë rezultatet, duke i punlikuar në <https://poeteka.blogspot.com>.

Kushtet e përgjithshme: Programi ofron katër javë qëndrim në Tiranë, duke vënë në dispozicion një shumë prej 800.00 EURO për shpenzimet e jetesës për muajin; gjithashtu programi do të mbulojë koston e udhëtimit (klasi ekonomik) *për dhe nga* Tirana, përfshirë qeranë dhe mirëmbajtjen. Gjatë qëndrimit, përkthyesi pritet të punojë intensivisht me projektin e përkthimit përmes të cilit ai/ajo ka aplikuar dhe do të marrë pjesë në veprimtaritë që POETIKA do të organizojë në kuadër të Projektit.

Kush mund të aplikojë? POETIKA mirëpret propozime nga përkthyesit letrarë që punojnë *nga ose në* gjuhën shqipe drejt gjuhëve të Bashkimit Europian. Përkthyesit e kualifikuar duhet të jenë qytetarë të një vendi të BE-së.

Translation in Motion është një Program që synon të pasurojë dhe intensifikojë prurjet e letërsisë bashkëkohore të përkthyer në Europë dhe konkretisht midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtare të BE-së.

Në përkrahje të idesë se përkthyesit letrarë janë ambasadorë me ndikim të fortë në nxitje të dialogut kulturor, ky Program do të sigurojë *mobilitetin* e përkthyesve dhe zhvillimin e tyre profesional. Rezidencat e Përkthimit u ofrojnë përkthyesve kohë për punë krijuese dhe mundësi për t'u përqendruar në një projekt të përkthimit letrar, për të qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me shqipen, si gjuhë burimore të përkthimit për ta, për të jetuar në kontekstin social-kulturor të kësaj gjuhe, për të kryer hulumtime dhe për të rritur profilin e tyre përmes krijimit të lidhjeve dhe përballjen me skenën letrare vendas edhe audiencën në Shqipëri.

Ju lutemi gjeni në faqen e website të [RECIT](#) detaje rreth mundësive të tjera të qëndrimit në Arles (Francë), Beograd (Serbi), Cetinje (Mali i Zi), Gotland (Suedi), Shkup (Maqedoni), Sofje (Bullgari), dhe Ventspils (Letoni) dhe Norwich (MB).

Lidhur me situatën e pandemisë të COVID-19, mund të ketë ndryshime të datave të qëndrimit, të cilat varen nga heqja e kufizimeve për udhëtimet ndërkombëtare dhe bllokimet në shtete të ndryshme. POETIKA do të garantojë masat e sigurta për COVID-19, në përputhje me udhëzimet të qeverisë dhe autoriteteve përkatëse.

Translation in Motion
is a joint residency program of



Co-funded by the
Creative Europe Programme
of the European Union



POETIKA

krokodil
Engaging Words



ATLAS
CTIL



National Centre
for Writing